

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Saranda Buzhala

**Miti si strukturë semantike dhe strategji
retorike në letërsinë shqipe mes dy luftërave
botërore**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2020

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF PHILOLOGY

Saranda Buzhala

***Myth as a deep semantic structure and
rehtorical strategy in Albanian literature
between world wars***

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

SARANDA BUZHALA

**Miti si strukturë semantike dhe strategji
retorike në letërsinë shqipe mes dy luftërave
botërore**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Prof. dr. Anton Berishaj

Prishtinë, 2020

REZYMEJA

Në punimin e doktoratës, me titull “Miti si strukturë semantike dhe strategji retorike në letërsinë shqipe mes dy luftërave botërore”, kemi parë që miti, si një referencë gjithpërfshirëse dhe ripërsëritëse, del në forma të ndryshme tek autorët që karakterizuan periudhën mes dy luftërave botërore. Miti, si një autoritet, si një referencë e gjithkohshme, me anë të një force lëvizëse bën vend në tekstet e tyre. Pikërisht gjithë sistemi që ndërtohet në këtë rast ishte objekt studimi për ne, duke parë lidhjet që krijohen, rimarrjet, raporti me mitet e origjinës, elementet novatore, gërshetimi me mitet shqiptare, prania e traditave dhe e kulturës shqiptare, efektet estetike, rikontekstualizimet, marrje-dhëniet, etj.

Autorët e periudhës mes dy luftërave botërore bëjnë rikontekstualizimin e miteve në tekstet e tyre përmes marrjes së temave, motiveve, personazheve, etj. Njohja e tyre me lëndën mitike sjell në tekstet e tyre rifunksionalizimin e saj. Varësisht prej interesimeve dhe orientimeve të autorëve në fjalë, ata sjellin në formën e tyre autoriale mite nga Antika greke, nga historia shqiptare, nga mitologjia shqiptare, bëjnë rindërtimin e legjendave, baladave shqiptare, etj.

Përveç marrjes së mitit, gjatë punimit është tentuar të shihet edhe niveli transformues i këtyre miteve dhe të gjitha elementet novatore, që autorët sollën përmes risemantizimit të tyre. Njëkohësisht, mënyra se si ata i sollën mitet e ndryshme dhe funksioni që ua dhanë atyre po ashtu del në pah përgjatë këtyre kapitujve.

Duke mos lënë anash as krahasimin me lëndën mitike origjinale, bëhet vështrim intertekstual. Njëkohësisht, aty ku kishte mundësi, është tentuar të shihet edhe përçasja intratekstuale.

Pasi që lënda kryesore e këtij punimi ka qenë miti, e kemi parë të nevojshme që ky punim doktorate të fillojë me një vështrim mbi mitin dhe çështje të tjera që lidhen me të dhe me letërsinë.

Përkufizimet e ndryshme mbi mitin dhe objekti i saj tentohet të parashtrihen përmes teoricienëve të ndryshëm, mendimet e të cilëve mund të përputhen ose jo mes vete.

Duke paraqitur mendimet e tyre (William K.Ferrel, Rober A.Segal, Roland Bart, Mircea Eliade, Laurence Cope, Andrew Von Hendi, etj.) gradualisht arrijmë deri te një vlerësim përfundimtar rreth përkufizimit të mitit dhe objektit të tij. Secili nga ta jep nga një detaj më ndryshe apo ide të re në përkufizimin e mitit, duke na ndihmuar që të krijojmë një koncept më të qartë se çka në të vërtetë është miti, objekti, roli dhe funksioni i tij. Si një organizim i tillë, miti bëhet një lëndë jashtëzakonisht e rëndësishme për letërsinë, me ç'rast jemi përpjekur të vëmë në pah këtë marrëdhënie. Ndërkaq, kapitullin e përmbylim me një vështrim panoramik mbi ndikimin e mitit në letërsinë shqipe, duke filluar që nga Letërsia e Vjetër.

Kapitulli i dytë i kushtohet Ernest Koliqit dhe është ndër më voluminozët. “*Miti i pasqyrimit*” është titulli që kemi konsideruar të përfaqësojë më së miri praninë dhe funksionin e mitit në shkrimet e këtij autori, për faktin se ai tenton të ndërtojë reflektimin e asaj lënde mitike në shkrimet e tij, të marrë qoftë nga Antika, apo edhe nga kultura shqiptare.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar veprës së tij “*Pasqyrat e Narcizit*”. E parë si rimarrje e mitit të Antikës mbi Narcisin, vepra ndërtohet në shtatë poemtha apo proza poetike. Ndërkaq, studimi i kësaj rimarrjeje koncentrohet në risitë që sjell autori në përdorimin e kësaj lënde mitike dhe funksionin e ri që ia jep, bashkë me elementet shqiptare që ia vesh këtij miti. Duke ruajtur simbolikën e kërkimit dhe të dashurisë ndaj asaj që është “e jotja”, Koliqi e zhvendos figurën e Narcisit në ambient shqiptar. Tashmë, kjo figurë nuk përfaqëson fundin tragjik për shkak të dashurisë, por shpëtimin nga dashuria. Ngase, Narcisi i Koliqit, pas gjithë kërkimit të lodhshëm, arrin të zbulojë të vërtetën, ndaj së cilës ishte vënë në kërkim.

Kësisoj, studimi i këtij miti lidhet me rifunksionalizimin nga ana e Koliqit, marrëdhënien intertekstuale me mitin e origjinës, elementet novatore që ndërfiten në tekst, marrëdhëniet intratekstuale, vështrim mbi personazhet, idetë, temën, etj.

Ndërkaq, tekstet e tjera të Koliqit ofrohen si një vështrim i përgjithshëm mbi praninë e mitit nacional në to. Duke u ndalur te mitologjia shqiptare dhe figurat e ndryshme mitike, kjo pjesë ofron një vështrim analitik të tyre.

Kapitulli pasues ka në qendër krijimet e F. Nolit. Studimi për veprën mbi figurën e Betovenit nis që nga treguesit paratekstualë të tekstit, për të vazhduar me fakte të ndryshme mbi këtë figurë të muzikës. E parë si një formë nga miti tek antimiti dhe nga antimiti te miti, jepen

fakte dhe elemente se si autori çmitizon fillimisht dhe pastaj e mitizon figurën e Betovenit. Në anën tjetër, autobiografia e tij ndërtohet mbi biografemat, si baza e mitit personal. Mitizimi i personalitetit të tij bëhet përmes një sistemi tekstor. Gjithë teksti është i mbushur me momente, nga të cilat thuren formula tekstore të autobiografisë së Nolit. Përmes këtyre formulave, bëhen kapërcime nga fëmijëria e hershme e deri në jetën e mëvonshme. Gradualisht ndërtohet miti i personalizuar. Ndërkaq, poezitë e Nolit janë me brumë mitologjik, kombëtar, por edhe fetar. Ndërsa, çmitizimi i këtyre figurave dhe elementeve mitologjizuese e çojnë poezinë e tij në një stad demistifikues dhe aktualizues, për kohën e krijuesit.

Te kapitulli për E.Haxhiademin, që është i katërti me radhë, kemi tentuar të studiojmë transformimin e miteve në veprat e tij. Duke e konsideruar si autor të modeleve klasike të dramaturgjisë, është tentuar të vihen në pah elementet që ai merr nga tragjedia klasike dhe ato që shënojnë risi nga ana e tij.

Haxhiademi ndërton shtatë tragjeditë e tij me subjekt të marrë nga lashtësia dhe Mesjeta shqiptare, nga mitologjia antike, si dhe nga ajo biblike, duke u dhënë frymën dhe veshjen e epokës në të cilën ai jeton. Duke ndjekur parimet e klasicizmit shtjellon subjekte tërheqëse dhe konflikte të ashpra, përmes karaktereve tragjike me virtyte apo vese. Ndërkaq, marrëdhëniet me tekstet e tjera na çuan drejt interpretimeve intertekstuale.

Përmes ballafaqimit të së mirës, së bukurës, së ndriturës, me të keqen, të ligën, të përçudnuarën, Haxhiademi sjell modelin klasik të tragjedisë në vargje. Për të parë më për së afërmi këto transformime, jemi përpjekur që të bëjmë diferencimin e tyre. Fillimisht vihet në pah transformimi i miteve biblike, të cilin e gjejmë te tragjedia e tij *“Abeli”*. Pastaj, në dramën *“Ulisi”* e *“Akili”* kemi vlerësuar se miti është njëjtësuar me ngjarjet reale historike, duke e mitologjizuar jetën e historinë. Me lëndë nga mitologjia greke, Haxhiademi ndërton edhe tragjedinë *“Diomedi”*. Kemi konstatuar se edhe te kjo tragjedi hasim një zvhendosje në kohë dhe hapësirë të këtij heroi mitik.

Në kuadrin e tragjedive, që kanë për subjekt historinë e shqiptarëve, kemi tragjeditë *“Aleksandri”*, *“Pirrua”* dhe *“Skënderbeu”*. Edhe në studimin që kemi bërë për këto tekste të Haxhiademit jemi përpjekur që të vëmë në pah raportin që autori ka ruajtur me mitin e origjinës dhe atë që e ka ndërtuar me elementet e reja që ndërfut në këto shkrime. Përveçse në dramatikë,

Haxhiademi motive mitologjike shpalos edhe në krijimtarinë e tij në vargje. Prandaj, përmes një vështrimi modest, jemi ndalur te poema e tij, *“Nimfat e Shkumbinit”*, duke vënë në pah motivet dhe figurat mitologjike, përmes të cilave ofrohet një tablo e gjerë e risjelljes së tyre, në frymën e jetës së vërtetë.

Kapitulli i pestë i kushtohet krijimtarisë së Gjergj Fistës dhe qëndron nën titullin *“Fishta-mit dhe realitet”*. Si autor i një numri të madh veprash, Fishta njëkohësisht bëhet edhe bartës i një larushie diskursesh e trajtesash. Duke kombinuar misionin me artin, ai mishëron në to gjithë korpusin kulturor, gjeografik e shpirtëror të shqiptarëve. Kësisoj, Fishta ndërton një univers të gjerë letrar, i cili qëndron mes mitikes dhe reales. Nga teksti në tekst, miti kombinohet fuqishëm me botën reale, me gjeografinë e mendësinë reale.

Prandaj edhe nuk janë të pakta rastet kur mitologjia shqiptare e elemente të marra nga hapësira gjeografike shqiptare, si: uji, toka, mali, etj., kombinohen me emra, vende e ngjarje reale, për të sintetizuar një të vërtetë mitike, për të dhënë mitin e ri, atë fishtjan.

Kemi arritur në përfundim se duke fuqizuar tregimet për Orët, Zanat e Dragonjtë, për kujtesën historike, e figurat e dalluara, për ngjarje e personazhe të njohura biblike dhe religjioze, Fishta këndon mitin nacional. Megjithatë, autori bën kombinimin e mitologjisë shqiptare me atë greko-romake, gjithmonë në kërkim të origjinalitetit. Prandaj edhe stili i tij, shumëngjyrësh, të jep ndjenjën e së veçantës në veprat e tij.

Autori tjetër, tek i cili jemi ndalur, është Migjeni. Në studimin mbi krijimtarinë e tij, kemi arritur në përfundimin që Migjeni zhvesh mite ekzistuese. Ai zgjedh të shkruajë për temat e zakonshme në një mënyrë më ndryshe. Përtej glorifikimeve dhe hyjnizimeve, Migjeni paraqet njerëzit e thjeshtë të vendit të tij. Tashmë personazhet e teksteve të tij nuk hyjnizohen e as hapësirat shqiptare nuk glorifikohen, mirëpo dalin në pah mungesat e vërteta të tyre, që i çojnë drejt zhvleftësimit dhe tëhuajimit.

Prandaj, krijimet e Migjenit, duke trajtuar temat e reja, shpërfaqin mite të reja. Nuk lihet pa u vënë në pah edhe krijimi i mitit të njeriut të ri, njeriut modern. Po ashtu, veprën e Migjenit lirisht mund ta quajmë parodi të modelit ekzistues, atij tradicional. Prandaj edhe kemi tentuar të vëmë në pah raportin më ndryshe që ai kishte me modelin dhe traditën e mëparshme letrare, duke krijuar një lloj distancimi. Kështu, kemi arritur në konstatimin se, nisur që nga detajet e për të përfunduar te forma artistike, Migjeni ndërton parodi. Duke thyer mitin e mëparshëm, ai ndërton

mitin e ri. Në parim ai çmitizon, duke mitizuar, duke sjellë diçka të re, por që tashmë ka kah të kundërt, qëllim tjetër.

Kapitulli pasues i është kushtuar Mitrush Kutelit. I parë si rrëfimtar, studimin e kemi filluar me vështrimin mbi këtë poetikë të tijën. Ndërkaq, për t'u futur në përdorimin e miteve nga ana e Kutelit, kemi vazhduar studimin me një vështrim mbi praninë e elementeve mitike, duke e parë të arsyeshme si njoftim me gjithë lëndën e mundshme mitike të pranishme në shkrimet e tij. Rëndësi të veçantë i kemi kushtuar tregimit "*Fshati im e pi rakinë*", në përpjekjen e krijimit të një analogjie të frymës mitike në këtë tregim me ritin dionisian. Kemi tentuar që të tërheqim një paralele mes asaj që dimë për ritet e Dionisit dhe mes asaj që njihet në përgjithësi dhe që na ka ofruar Kuteli në këtë tregim për traditën e pirjes së kësaj pijeje në Pogradec. Dhe, kemi arritur në përfundimin se si fanatikë të traditës dhe të kulturës, si adhurues të kënaqësisë dhe gëzimeve të jetës dhe si kundërshtues të kufizimeve të njeriut nga sistemi i jetës, pogradecianët hapin dhe mbyllin ditën me verë e raki. Nuk është lënë pa u vënë në pah edhe diskursi fantastik dhe bota mitologjike shqiptare. Prania mistike tek "*E madhe është gjëma e mëkatit*" gjithashtu shënon përpjekjen tonë të radhës për interpretim. Duke shfrytëzuar kodin fetar, Kuteli tenton të japë përgjigje për ato pikëpyetje dhe dilema tokësore e shpirtërore. Prandaj edhe këtë kod do ta zhvendosë në kohë dhe hapësirë. Kurse, në vazhden e analizës së këtij teksti, jemi ndalur edhe te dhurimi i pavdekësisë, e te miti i jetës dhe vdekjes, si dy nga shtyllat kryesore të ekzistencës njerëzore. Për të vazhduar me analizën komparative mbi "*E madhe është gjëma e mëkatit*" e Mitrush Kutelit dhe tregimin "*Atë Sergi*" të Leon Tolstoit. Ndërkaq, studimi rreth këtij autori përmbillet me analizën e bërë mbi rimarrjen e motiveve popullore nga Kuteli.

Pas gjithë punës së bërë mbi studimin e autorëve ndaras prej njëri-tjetrit, është parë e rrugës që punimi të përmbillet me një vështrim përmbledhës, që në qendër do të ketë ballafaqimin e të përbashkëtave dhe të kundërtave mes tyre. Duke qenë autorë të së njëjtës periudhë dhe duke qenë shfrytëzues të përbashkët të lëndës mitike, të vendosurit pranë njëri-tjetrit na ndihmoi që të vëmë në pah diferencat apo afritë që kanë mes vete. Krahasimi mes tyre apo edhe hetimi i niveleve të intertekstualitetit të njëri apo te tjetri autor, na ka ndihmuar që të vëmë në pah karakteristika të këtyre autorëve. Rikontekstualizimi i miteve të Antikës, rimarrja e kodit biblik e prania e botës mitologjike shqiptare janë parë të pranëvëna te këta autorë.

Nga gjithë ajo çka u prezantua më lart, mund të themi që punimi paraqet një punë të gjatë dhe të detajuar mbi krijimtarinë e autorëve që bëjnë pjesë në periudhën mes dy luftërave botërore, duke pasur për bazë lëndën mitike në shkrimet e tyre.

Përmes paraqitjes gjithpërfshirëse, analizës së detajuar, studimit analitik e komparativ, jemi përpjekur që të bëjmë një lexim më ndryshe të teksteve të këtyre autorëve dhe të sjellim një interpretim nga këndvështrimi ynë rreth miteve të pranishme në shkrimet e tyre.

Prandaj edhe shpresojmë shumë që punimi ynë të jetë i dobishëm për të interesuarit e kësaj fushe dhe të sjellë një vështrim më ndryshe mbi problematikën letrare të trajtuar.

RESUME

In this doctoral dissertation, titled “Myth as a deep semantic structure and rhetorical strategy in Albanian literature between world wars”, we saw that the myth, as a comprehensive and repetitive reference, emerges in various forms to the authors who characterized the period between the two world wars. Myth, as an authority, as a perpetual reference, by means of a driving force makes its place in their texts. Exactly the whole system that was built in this case was the object of study for us, looking at the connections that were created, the recaptures, the relation with the myths of origin, the innovative elements, the interweaving of Albanian myths, the presence of Albanian traditions and culture, the aesthetic effects, recontextualization, relationships, etc.

The authors of the period between the two world wars recontextualize the myths in their texts by taking themes, motives, characters, etc. Their acquaintance with the mythical subject brings to their texts its re-functioning. Depending on the interests and orientations of these authors, they bring in their authorial form myths from Greek Antiquity, Albanian history, Albanian mythology, reconstruction of Albanian legends, ballads, etc.

In addition to capturing the myth, it is attempted to look at the transformative level of these myths and all the innovative elements that the authors brought through their re-enactment. At the same time, the way they brought up the various myths and the function they gave them also emerges throughout these chapters. Not leaving aside the comparison with the original mythical subject matter, an intertextual look is made. At the same time, where possible, intra-textual approaches have also been attempted.

As the main subject of this paper has been myth, we have found it necessary to begin this doctoral thesis with a look at myth and other issues related to it and literature.

Different definitions of the myth and its object tend to be put forward by different theorists whose opinions may or may not overlap.

By presenting their opinions (William K. Ferrel, Rober A. Segal, Roland Bart, Mircea Eliade, Laurence Cope, Andrew Von Hendi, etc.) we gradually come to a definitive assessment

of the definition of myth and its object. Each of them gives a different detail or new idea to the definition of myth, helping us to create a clearer concept of what the myth, object, role and function really is. As such, myth becomes an extremely important subject for literature, in which case we have tried to highlight this relationship. The chapter concludes with a panoramic overview of the influence of myth on Albanian literature, starting with Old Literature.

The second chapter is dedicated to Ernest Kolic and is one of the most voluminous. "The Myth of Reflection" is the title that we have considered to best represent the presence and function of the myth in this author's writings, for the fact that he attempts to construct a reflection of that mythical subject in his writings, whether taken from Antiquity, or also from Albanian culture.

Special attention has been paid to his work "The Mirrors of Narcissus". Seen as a recapture of the Antiquity myth of Narcissus, the work is built on seven poems or poetic prose. Meanwhile, the study of this recapture focuses on the novelties that the author brings to the use of this mythical subject and the new function he gives, along with the Albanian elements that he attributes to this myth. Preserving the symbolism of seeking and loving what is "yours", Koliqi relocates the image of Narcissus to the Albanian environment. Now, this picture does not represent the tragic end of love, but the salvation of love. Because, after all the tedious search, Kolic's Narcissus manages to discover the truth he was looking for.

Thus, the study of this myth relates to Koliqi's re-functioning, the intertextual relationship with the myth of origin, the innovative elements that are incorporated in the text, the intra-textual relations, the look at the characters, ideas, theme, etc.

The following chapter focuses on F. Noli's creations. The study of the work on Beethoven's figure starts from the pre-textual indicators of the text, to proceed with different facts on this figure of music. Seen as a form of myth to anti-myth and from anti-myth to a myth, facts and elements are given of how the author first demystifies and then creates a myth about Beethoven's figure. On the other hand, his autobiography is builded on biographies as the basis of personal myth. The myth of his personality is made through a textual system. All of the text is full of moments from which Noli's autobiographical textual formulas are created. Through these formulas, are overcome from early childhood to later life. Custom myth is gradually being built.

Meanwhile, Noli's poems are mythical, national, but also religious. Whereas, the demystification of these mythological figures and elements takes his poetry to a demystifying and actualizing stage, for the time of the creator. In the fourth chapter in the chapter on E. Haxhiadem, we have attempted to study the transformation of myths into his works. Considered as the author of classical models of dramaturgy, it is attempted to highlight the elements he derives from classical tragedy and those that mark his novelty.

Haxhiademi builds on his seven tragedies with the subject taken from the ancient and Albanian Middle Ages, from ancient as well as biblical mythology, giving them the spirit and clothing of the era in which he lives. Following the principles of classicism, he elaborates on attractive subjects and fierce conflicts, through tragic characters with virtues or vice. However, relationships with other texts led us to intertextual interpretations.

By confronting the good, the beautiful, the bright, the evil, the despised, Haxhiademi brings the classic pattern of tragedy to verses. To take a closer look at these transformations, we have tried to differentiate them. First, the transformation of the biblical myths that we find in his Abel tragedy is highlighted. Then, in the plays "Ulisi" and "Achilles" we have estimated that the myth is equated with real historical events, mythologizing life and history. With subjects from Greek mythology, Haxhiadem also builds on the "Diomedi" tragedy. We have found that even in this tragedy we find a shift in time and space of this mythical hero.

In the context of the tragedies that have to do with the history of Albanians, we have the tragedies "Alexandria", "Pyrrhus" and "Skanderbeg". Even in our study of these texts of Haxhiadem, we have tried to highlight the relation that the author has preserved with the myth of origin and what he has constructed with the new elements that he inserted in these writings. In addition to the dramatics, Haxhiademi also reveals mythological motifs in his verse creativity. Therefore, through a modest look, we dwell on his poem, "The Nymphs of Shkumbin", highlighting the mythological motifs and figures through which a broad picture of their remembrance is offered in the spirit of real life.

The fifth chapter is devoted to the creativity of Gjergj Fishta and is under the heading "Fishta-myth and reality". As the author of a large number of works, Fishta is at the same time the bearer of a variety of discourses and traditions. Combining mission with art, it embodies in

them the entire cultural, geographical and spiritual corps of Albanians. Thus, Fishta builds a vast literary universe that stands between myth and reality. From text to text, myth is strongly combined with the real world, with geography and real mindset.

Therefore, there are many cases when Albanian mythology and elements taken from the Albanian geographical space, such as: water, land, mountain, etc., are combined with real names, of places and events, to synthesize a mythical truth, to give the new myth, that Fishtjan myth.

We have come to the conclusion that by reinforcing the stories of Hours, Fairies And Dragons memory, prominent figures, known biblical and religious events and characters, Fishta sings the national myth. However, the author combines Albanian mythology with Greco-Roman literature, always seeking authenticity. That is why his style, multicolored, gives you a sense of uniqueness in his works.

The other author we've stopped is Migjeni. In studying his creativity, we have come to the conclusion that Migjen strips away existing myths. He chooses to write about common topics in a different way. Beyond glorifications and deities, Migjen presents the common people of his country. Now the characters of his texts are not deified, nor are the Albanian spaces glorified, but their true shortcomings emerge, leading them to devaluation and alienation.

Therefore, Migjeni's creations, by treating new themes, reveal new myths. The creation of the myth of the young man, the modern man, is not overlooked. Likewise, Migjeni's work can freely be called a parody of the existing model, the traditional one. That is why we have attempted to highlight the different relationship he had with the previous literary model and tradition, creating a kind of distancing. Thus, we have come to the conclusion that, starting from the details to finishing in the artistic form, Migjeni constructs a parody. By breaking the previous myth, he builds the new myth. In principle, it demystifies, myths, bringing something new, but already opposite, another goal.

The next chapter is dedicated to Mitrush Kuteli. Seen as a confessor, we began our study with a look at this poetry of his own. Meanwhile, to get into Kuteli's use of myths, we have continued our study with a glance at the presence of mythical elements, seeing it as reasonable notice of all the possible mythical subject matter present in his writings. Particular importance has been given to the story "My village drank rakia" in trying to create an analogy of the

mythical spirit in this story with the Dionysian rite. We have attempted to draw a parallel between what we know about the Dionysian rites and what is generally known, and that Kuteli offered us in this account of the tradition of drinking this drink in Pogradec. And, we have come to the conclusion that as fanatics of tradition and culture, as worshipers of the pleasures and joys of life, and as opposers of man's limitations on the system of life, Pogradecians open and close the day with wine and brandy. The fantastic discourse and the Albanian mythological world are not overlooked. The mystical presence in "Great is the rumble of sin" also marks our next attempt at interpretation. Utilizing the religious code, Kuteli attempts to answer those questions and the temporal and spiritual dilemmas. Therefore this code will also move it in time and space. And, in the course of analyzing this text, we have also focused on the gift of immortality, the myth of life and death, as two of the main pillars of human existence. To continue the comparative analysis on Mitrush Kuteli's "Great is the scourge of sin" and Leon Tolstoy's "Priest Sergi". The study of this author, however, concludes with an analysis of the recapture of popular motifs by Kuteli.

After all the work done on the study of authors separately from each other, it has been seen as a way to conclude the paper with a concise overview that will have at the heart of the commonalities and opposites between them. Being authors of the same period and being common users of mythical subject matter, being close to one another helped us to point out the differences or relationships between them. Comparing them or even investigating the levels of intertextuality of one author or another, has helped us to identify the characteristics of these authors. The recontextualization of the Antiquity myths, the recapture of the biblical code, and the presence of the Albanian mythological world have been seen closely by these authors.

From all of the above, we can say that the work is a long and detailed work on the creativity of authors who are part of the period between the two world wars, based on the mythical subject matter in their writings.

Through a comprehensive presentation, detailed analysis, analytical and comparative study, we have attempted to read the texts of these authors in a different way and to provide an interpretation from our point of view of the myths present in their writings.

Therefore, we very much hope that our work will be useful to those interested in this field and bring a different perspective on the literary issues addressed.